



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI

VENDIM

Nr. 8 datë 28.02. 2022

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN SHKURT 01-28.02.2022.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 107, datë, 24.12.2021 për “Për Miratimin e Buxhetit 2021” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 1.200.000 lekë/ vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër.

VENDOSI :

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Shkurt 2022, 34 individë/ familje** me **fond 97,506 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT  
Etleva Yzo



KRYETARI I KËSHILLIT  
Lavdi Hasani